Indeksi i Kapitalit Human

Burimi: Banka Botërore

Indeksi i Kapitalit Human (HCI) është një indeks i përllogaritur nga Banka Botërore. Indeksi mat kapitalin human të gjeneratës së ardhshme, përcaktuar si sasia e kapitalit human, që një fëmijë i lindur sot mund të presë të arrijë duke pasur parasysh rreziqet e shëndetit dhe arsimin e dobët që aktualisht mbizotëron në vendin ku ai fëmijë jeton.

Indeksi varion midis 0 dhe 1. Një vend në të cilin një fëmijë i lindur sot mund të presë që të arrijë shëndet të plotë dhe potencial të plotë arsimor shënon një vlerë prej 1 në indeks. Rezultati prej 0.80 sinjalizon se produktiviteti si një punëtor i ardhshëm për një fëmijë të lindur sot do të jetë 20% më poshtë se çfarë mund të ishte arritur me arsimim dhe shëndet të plotë.

Indeksi i Kapitalit Human përbëhet nga tre blloqe ndërtuese të kapitalit human të gjeneratës së ardhshme si, mbijetesa, shëndeti dhe shkolla. Mbijetesa nënkupton nëse fëmijët e lindur sot do të arrijnë moshën 18 vjeç. Shëndeti paraqet mundësitë që fëmijët e lindur sot të dalin nga shkolla në shëndet të mirë dhe të gatshëm për të vazhduar studimet ose punën. Ndërsa shkolla tregon sa vite shkollë do të kenë kryer dhe sa do të kenë nxënë deri në moshën 18 vjeçare.

Mbijetesa **&** **Shëndeti** **&** **Shkolla** **=** **HCI**

Indeksi i Kapitalit Human në Shqipëri merr vlerën 0.62, që nënkupton se një fëmijë i lindur sot në Shqipëri do të ketë një produktivitet si forcë punëtore e ardhshme rreth 38% më të ulët se në rastin kur do të zotërohej shëndet dhe arsim i plotë. Ndërsa duke marrë parasysh dhe gjininë, fëmijët shqiptarë të gjinisë femërore të lindur tani, sipas indeksit do të kënë të jenë produktivë më përkundrejt atyre meshkuj.

Përsa i përket renditjes së vendeve ballkanike perëndimore, pritet që fëmijët serb të lindur sot të jenë më produktivët në rajon, me 0.76 pikë. Për Bosnje-Hercegovinën dhe Malin e Zi është e njëjta pritshmëri si e Shqipërisë, me 0.62 pikë. Kosova merr 0.56 pikë në HCI, ndërsa Maqedonia renditet e fundit në rajon me 0.53 pikë, duke pritur që fëmijët e lindur aty të jenë më pak produktivët.

Grafiku 1: Ndryshimet e HCI-së në Shqipëri sipas gjinisë



Grafiku 2: Pikët e HCI-së në vendet e Ballkanit Perëndimor